

Takimi i 10-të online në kuadër të projektit “*SINCERE*”
(ERASMUS-EDU-2025-CBHE).

Në datën 21 prill 2026 u zhvillua takimi i 10-të online koordinues në kuadër të projektit “*Strengthening Integrity and Ethical Culture in Regional Higher Education – SINCERE*” (ERASMUS-EDU-2025-CBHE).

Gjatë takimit u diskutua progresi i analizës së pyetësorëve në kuadër të WP2, përfshirë rishikimin e propozimit për platformën (dashboard) dhe planifikimin e moduleve të trajnimit. Në WP3 u trajtuan çështje që lidhen me procesin e prokurimit, përfshirë statusin e dokumentacionit nga partnerët dhe ecurinë e përzgjedhjes së furnitorëve, si dhe disbursimin e fondeve për partnerët shqiptarë.

Në kuadër të WP4 u raportua mbi ecurinë e aktiviteteve të shpërndarjes dhe komunikimit, përfshirë planifikimin e eventeve të brendshme dhe rritjen e përfshirjes së platformave digjitale si palë të interesuara. Gjithashtu, u shqyrtua përditësimi i regjistrit të rreziqeve për periudhën 6-mujore, duke evidentuar ndryshimet kryesore dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

Takimi përfundoi me diskutime mbi rreziqet e reja potenciale dhe dakordësimin për hapat e mëtejshëm në zbatimin e projektit.

